# LIDHJA E REFORMAVE STRUKTURORE DHE KORNIZAVE FISKALE

Janez Šušteršič, Ekspert bashkëpunëtor i CEF

Financuar nga Bashkimi Evropian

# Struktura

**REFORMAT STRUKTURORE NË PRE**
- Evoluimi i termit “reformat strukturore”
- Përzgjedhja (prioritizimi) i reformave
- Planifikim i mirë i masave të reformës
- Zbatimi dhe monitorimi i reformave

**LIDHJA E REFORMAVE STRUKTURORE DHE KORNIZAVE FISKALE**
- Kostimi dhe buxhetimi i reformave strukturore
- Parashikimi buxhetor i PRE-ve
- Konsistenca e PRE-ve
- Reformat strukturore dhe planifikimi afatmesëm buxhetor

# Evoluimi i termit “reformat strukturore”

- Reformat strukturore janë bërë të popullarizuara me theks në fleksibilitetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomive, për dallim nga makro-menaxhimi i cikleve ekonomike - i njohur edhe si “ekonomia nga ana e ofertës”
- Strategjia e Lisbonës e BE-së (2000) u përpoq të kombinojë nxitjen për konkurrueshmëri me modernizimin e “Modelit Social Evropian”
- Përkufizimi i PRE-së kombinon konkurrueshmërinë me nevojën për të përmirësuar punësimin dhe mirëqenien - kjo reflekton sfidat zhvillimore kryesore në vendet kandidate dhe kandidate potenciale.

# Përkufizimi i PRE-së për reformat strukturore

**Termi reformë strukturore do merret se nënkupton politika publike që:**

- **adresojnë pengesat për nxitësit themelorë të rritjes,**
- **lehtësojnë përdorimin e resurseve dhe faktorëve produktiv në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundur**
- **ose që kontribuojnë për një ekonomi më të drejtë dhe më përfshirëse.**

**(Udhëzuesi i PRE-së 2019)**

Kjo përfshinë politika që:

- i modernizojnë **tregjet e punës** dhe i bëjnë ato më të adaptueshme dhe më përgjegjëse,
- i bëjnë **produktet dhe tregjet e shërbimeve** më efikase ,
- e thjeshtësojnë **mjedisin rregullativ** për bizneset duke e rritur në të njëjtën kohë transparencën e përgjithshme në ekonomi,
- krijojnë mundësi të barabarta dhe sigurojnë **përfshirje sociale**.

Investimet publike në **infrastrukturë** mund të përfshihen si masë nëse kontribuojnë në reformimin e tregut.

# Përzgjedhja (prioritizimi) i reformave

*Bazuar në Manualin e Prioritizimit të OECD-së*

**PYETJET EKZAMINUESE (CUT-OFF)**

- Adresimi i kufizimit detyrues ndaj rritjes?
- Kapacitetet dhe financimi i mjaftueshëm për zbatim?
- Aktivitetet e definuara qartë për zbatim?

**PYETJET PËRZGJEDHËSE:**

- Ndikimi në konkurrueshmëri/ rritje
- Ndikimi në punësim
- Kompleksiteti i zbatimit
- rreziqet e zbatimit
- Vlerësimi i masës nga KE (nëse aplikohet)

# Planifikim i mirë i masave të PRE-së

- Caktoni vetëm një objektiv për secilën masë
- Sqaroni lidhjen me pengesat për konkurrencën dhe punësimin
- Përshkruani qartë se çfarë është ajo masë
- Specifikoni aktivitetet konkrete me rezultatet e pritura të tyre
- Përfshini treguesit kyçë të performancës

# Reformat në PRE-të 2019-2022

*Bazuar në 7 PRE-të, Kap. 4.2 Përmbledhja e Masave të Reformës*

| Sektori i politikave PRE | Nr. | Përqind | Reformat më të shpeshta |
|---|---|---|---|
| Tregjet e energjisë dhe transportit | 21 | 16 % | Liberalizimi/ hapja e tregut<br>Efiçenca e energjisë, burimet e ripërtërishme<br>Infrastruktura |
| Zhvillimi sektorial | 18 | 14 % | Investimi në bujqësi, prodhim<br>Politika industriale<br>Turizmi |
| **Mjedisi për biznes** | **36** | **27%** | Ulja e barrës rregullative, e-shërbimet<br>Ekonomia joformale, mbledhja e tatimit, inspektimit<br>Mbështetja për NVM-të |
| RDI dhe ekonomia digjitale | 15 | 11 % | Sistemi i RDI-së dhe mbështetja<br>Infrastruktura/rregullimi [i rrjetit] brezgjerë (broadband) |
| Reformat lidhur me tregtinë | 8 | 6 % | Lehtësimi i tregtisë |
| Arsimi dhe shkathtësitë (aftësitë) | 16 | 12 % | Harmonizimi i AAP-së me nevojat e tregut të punës |
| Punësimi dhe tregjet e punës | 8 | 6 % | Masat e politikave aktive të tregut të punës |
| Përfshirja sociale | 10 | 8 % | Sistemi i mbrojtjes sociale<br>Sistemi shëndetësor |

# Zbatimi i reformave

| Zbatimi i reformave në vitin 2018 | |
|---|---|
| Nuk janë zbatuar (0) | 0 % |
| Në përgatitje (1) | 9 % |
| Zbatimi fillestar (2) | 34 % |
| Në vazhdim (3) | 26 % |
| I avancuar (4) | 26 % |
| I përfunduar (5) | 5 % |

Llogaritur nga vlerësimi i KE-së në bazë të raportimit të zbatimit në PRE-të 2019-21, Tabela 11 (Turqia dhe BeH nuk janë përfshirë)

| Zbatimi i udhëzimeve të politikave specifike për vendin në vitin 2018 | |
|---|---|
| I kufizuar | 3 shtete |
| Pjesërisht | 4 shtete |

Bazuar në vlerësimin e Komisionit Evropian të 7 PRE-ve 2018-20 (Prill 2019).

| | |
|---|---|
| ***Pse është aq i vështirë zbatimi?*** | **Planifikim jo i saktë i aktiviteteve?**<br>**Mungesë e rregullimeve të duhura të raportimit dhe monitorimit?**<br>**Kapaciteti institucional, njerëzor dhe financiar për zbatim?**<br>**Mospërputhje ndërmjet masave të PRE-së dhe prioriteteve kryesore politike?** |

# Lidhja e reformave me kornizën fiskale

## Kostimi dhe buxhetimi i reformave (PRE, Kapitujt 4 & 5)

KOSTIMI: Kostoni plotësisht çdo aktivitet i masës.

BUXHETIMI: Sigurohuni që financimi i planifikuar buxhetor të jetë në përputhje me buxhetin e aprovuar dhe me dokumentin e KASH-it – të kontrollohen zërat nga Departamenti i Buxhetit në MF.

MBLEDHJA E KOSTOS SË PËRGJITHSHME: Në Kapitullin 5 llogaritni kostot totale të pritura të reformave sipas vitit, dhe financimin total buxhetor të pritur për vit. Nënvizoni reformat më të kushtueshme dhe financiarisht më të rrezikshme.

# Lidhja e reformave me kornizën fiskale

## Perspektiva buxhetore afatmesme (PRE, Kapitulli 3.3)

PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE: Sigurohuni që të paktën reformat më të kushtueshme të përmenden në mesin e prioriteteve të shpenzimit - koordinatori i reformave strukturore të PRE-së ta kontrollojë tekstin e këtij kapitulli.

PARASHIKIMI I TË HYRAVE: Specifikoni se a janë përfshirë në vlerësime efektet e pritura nga reformat strukturore. Nëse po, jepni vlerësime sasiore të rezultateve të pritura.

KORNIZA MAKROEKONOMIKE: Specifikoni se është i përfshirë ndonjë prej efekteve të pritura ekonomike të reformave në skenarin bazë i cili është përdorur për projeksione fiskale. Nëse po, paraqitni vlerësime sasiore të efekteve të pritura në rritjen ekonomike dhe në buxhet.

# Lidhja e reformave me kornizën fiskale

## Korniza për konsistencë të brendshme të PRE-së

| REFORMAT STRUKTURORE | | KORNIZA MAKROFISKALE |
|---|---|---|
| 4. Hyrje<br>4.2 Përmbledhje e masave | STRATEGJIA | 1. Korniza e përgjithshme e politikave<br>3.1 Strategjia e politikës fiskale |
| 4.1., 4.3. Pengesat kryesore<br>4.3. Ndikimi i pritur | DIAGNOSTIKA | 2.1. Zhvillimet ekonomike<br>2.2., 2.3 Skenarët makroekonomikë |
| 4.3. Kostot e vlerësuara<br>5. Kostimi dhe financimi i reformave | IMPLIKIMET FISKALE | 3.3 Perspektiva buxhetore<br>3.6 Analiza e ndjeshmërisë |

# Lidhja e reformave me kornizën fiskale

## Sigurimi i konsistencës përmes bashkëpunimit

- Strategjia. **Politikë-bërësit** duhet të përfshihen herët në proces për të përcaktuar strategjinë e përgjithshme të politikës.

- Diagnostika. **Njësia makroekonomike** dhe **koordinatori i reformave strukturore** duhet të harmonizojnë qëndrimet e tyre mbi sfidat kryesore dhe efektet e mundshme të reformave.

- Implikimet fiskale. **Ministritë e linjës** dhe **departamenti i buxhetit** duhet të sigurojnë që kostot e reformave të jenë realiste, të financuara dhe të pasqyruara në perspektivën afatmesme buxhetore. **Koordinatori për reformat strukturore** duhet të sigurojë që reformat kryesore të përmenden në kapitullin fiskal dhe makroekonomik.

# Lidhja e reformave me kornizën fiskale

## Dokumenti i planifikimit afatmesëm buxhetor

REKOMANDIM I PËRGJITHSHËM: Bëjeni financimin e prioriteteve kryesore, përfshirë reformat strukturore të PRE-së, të dukshëm në dokument.

QASJET E MUNDSHME:

- Buxhetimi i programit të plotë.
- Buxhetimi i pjesshëm i programit të reformave dhe prioriteteve kryesore
- Linja të ndara buxhetore për reformat dhe prioritetet kryesore
- Paraqitja e shpenzimeve sipas sektorëve.
- Paraqitja e një buxheti të veçantë për "reforma dhe investime".
- Shfrytëzoni klasifikimet e shpenzimeve bazuar në politika (klasifikimin programor; klasifikimin sipas funksioneve të qeverisë - COFOG)
- Kërkoni nga ministritë e linjës të paraqesin kërkesa për politikat dhe objektivat e jo për shpenzimet/kostot (në rritje)
- Bazoni negociatat për buxhetin në argumente që lidhen me politika dhe prioritete.